



**BASHKIA TIRANË  
KËSHILLI BASHKIAK**

**V E N D I M**

Nr. 19, datë 20.02.2017

**Për**

**“DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 59, DATË 30.12.2015 PËR “SISTEMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË QYTETIN E TIRANËS” (I NDRYSHUAR)”**,”

Në mbështetje të nenit 8, pika 2; nenit 9, pikat 1/1.1, shkronja “b”, nenit 9, pika 1/1.3, shkronja “b”, nenit 35 pika 3 dhe 5 dhe nenit 54, shkronja “f” të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen vendore”; nenit 113 të Ligjit nr.44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë; nenit 157, pika 3 të Ligjit nr.8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar); Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 për “Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar); Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar); Ligjit nr.115/2014, datë 31.07.2014 për “Ndarjen Administrativo-Territoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar) si dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.59, datë 30.12.2015, për “Sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës” (i ndryshuar) me propozim të Kryetarit të Bashkisë Këshillit Bashkiak,

**V E N D O S I:**

**1.** Të miratojë një shtesë në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.59, datë 30.12.2015 për “Sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës” (i ndryshuar), si vijon:

(i) Në pikën I.d, paragrafi 2, pika 2/1 - Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë nga Ndertimet e Reja, fjalia e fundit ndryshohet si më poshtë:

*Vlera e investimi llogaritet sipas koston mesatare të ndërtimit të banesave të miratuar nga Enti Kombëtar i Banesave ose preventivin e investimit te ri të paraqitur nga subjekti i interesuar dhe përzgjidhet vlerën më të lartë midis të dyjave.*

(ii) Në pikën I.d - Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë nga Ndertimet e Reja pas paragrafit të fundit shtohet pika “Përrjashtime” si më poshtë:

**Përrjashtime:**

Përfshihen nga detyrimi i pagesës së Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë nga Ndërtimet e Reja shoqëritë me kapital të zotëruar nga Bashkia e Tiranës në masën 100% dhe ndërmarrjet e Bashkisë Tiranë për të gjitha ndërtimet e reja apo ndërhyrjet reabilituese në infrastrukturën ku investitor apo përfitues i një projekti të financuar nëpërmjet granteve apo huave janë këto të fundit.

(iii) Në Pikën II.e “Tarifa e Institucioneve të tjera”, shtohet pika II.e.7 “Tarifa për shërbimin e karroatrecit”, si më poshtë:

- ***Tarifa e shërbimit me karroatrec për çdo transport mjete: 4.000 lekë***

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Puneve Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Policia Bashkiake.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

K R Y E T A R

**ALDRIN DALIPI**